

Mbi

Auditimin e Brendshëm

Ushtruar në SportKlub Vllaznia

Njesia e Auditimit Brendshem – Bashkia Shkoder bazuar ne ligjin 114/2015 “Per Auditimin e Brendshem ne sektorin publik”, VKM nr 212 date 30.03.2012 “Per miratimin e kriterëve per ngritjen e Njesive te Auditimit te Brendshem ne sektorin publik”, zhvilloi

nje mision auditimi te plote ne SportKlub Vllaznia per periudhen 01.01.2012 - 30.12.2015ku nga auditimi rezultoi:

PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE.

SportKlub Vllaznia ka mangësi në perpilimin dhe miratimin e rregullores së brendëshme, nuk janë percaktuar pergjegjesite sipas linjave te raportimit, nuk eshte ngritur grupi i menaxhimit strategjik, nuk eshte perpiluar deklarata e misionit, vizionit dhe objektivave, mungon regjistri i rrishtit, nuk jane percaktuar procedurat e brendshme te sinjalizimit parregullsive dhe antikorrupsionit. Ka mangesi ne mbajtjen e dosjeve te personelit, nuk eshte bërë vlersim i punës së punonjësve, nuk jane lidhur kontrata me punëmarresin, nuk janë percaktuar detyrat funksionale të punonjësve, nuk janë percaktuar dhe ndjekur fushat me rrisht të lartë. Ka mangesi ne planifikimin e buxhetit,si dhe ne miratimin e perpilimin e gjurmes auditit per zbatimin e buxhetit, nuk është_ushtruar kontroll i brendshem.Trajtimet ushqimore nuk eshte hartuar paraprakisht lista e sportisteve perfitues, nuk eshte hartuar mareveshje dypaleshe e perfitimit,sportistet jane trajtuar me kuota ushqimi te diferencuara te paargumentuara,si dhe sportistet jane trajtuar me shume se nje here me kuota ushqimore per te njeiten periudhe.Ndersa per honoraret e trajnierreve ”, nuk esht bere miratimi paraprak i listes se sportisteve profesionist sipas sporteve,nuk esht dokumentuar perzgjedhja e trajnierreve sipas sporteve,ka mangesi ne formulimin e kontrates me trajnieret. Ka mangesi ne hartimin dhe miratimin e rregullores per menaxhimin e asetëve, per planin e veprimt lidhur me mirembajtjen e aktiveve, per ndjekjen ne rruge ligjore per marrjen ne perdorim te asetëve qe jane ne perdorim nga te tretet,per ngritjen e komisionit te posacem per nxjerrjen e aktiveve nga perdorimi,si dhe ne administrin e automjete ne pronesi te SportKlub “Vllaznia”. Nuk jane hartuar politika vendore ne fushen e sportit dhe strategji lidhur me zhvillimin e sporteve ne Shkoder, nuk ka propozuar iniciative ligjore per fillimin e procedurave te transferimit te Sportklubit ne shoqeri anonime prane ish/Kryetarit te Bashkise dhe Kryetares se Bashkise

GJETJET DHE REKOMANDIMET

1.Gjetje. Ka mangësi në perpilimin dhe miratimin e rregullores së brendëshme, nuk janë percaktuar pergjegjesite sipas linjave te raportimit, nuk eshte ngritur grupi i menaxhimit strategjik, nuk eshte perpiluar deklarata e misionit, vizionit dhe

objektivave, mungon regjistri i rrishtit, nuk jane percaktuar procedurat e brendeshme te sinjalizimit parregullsive dhe antikorrupsionit .

2.Gjetje:Ka mangesi ne planifikim dhe mbledhje te te ardhurave per vitet 2012-2015, planifikimi i shpenzimeve nuk eshte bere bazuar ne nevojat e institucionit, si dhe realizimi i shpenzimeve nuk është bërë sipas planifikimit,Ka rritje te shpenzimeve nder vite, pa dhene nje argumentim lidhur me shtimin e shpenzimeve.

Rekomandime

a. Përshtatjen e rregullores se brendshme në përputhje me ligjin nr. 10296 date 08.07. 2010“Per menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, detajimin ne menyre analitike te te gjitha aktiviteteve qe kryen cdo punonjes, detajimin e sistemit të kontrollit sipas aktiviteteve, miratimin e rregullores nga Kryetare e Bashkisë. (bashkelidhet modeli i rregullores).

b. Përcaktimin e objektivave te institucionit, vleresimin e mundesise së ndodhjes se ngjarjeve, *si dhe perpilimin e regjistrit te rrishtit*, sipas modelit të rastit studimor nr. 04 të manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

c. Ngritjen dhe funksionimin e Grupit menaxhimit strategjik, ku ne perberje te jene drejtuesit kryesore te institucionit.

d. Vendosjen e procedurave te brendëshme te sinjalizimit parregullsive dhe antikorrupsionit .

e. Ne rregullore ne institucionit te parashikohen procedurat e sistemit te monitorimit dhe informimit, bazuar dhe ne manualin e menaxhimit financiare dhe kontrollit.

3.Gjetje :Ka mangesi ne mbajtjen e dosjeve te personelit, nuk eshte bërë vlersim i punës së punonjësve, nuk jane lidhur kontrata me punëmarresin, duke vepruar ne kundershtrim me nenin 12 te ligjit nr. 9761 date 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar,por punonjesit jane emeruar ne detyre, nuk ka nje procedure e dokumentacion te njejte per trajnieret profesionit,nuk janë përcaktuar detyrat funksionale të punonjësve, nuk janë përcaktuar dhe ndjekur fushat me rrisht të lartë:

Rekomandime

a.Lidhjen e kontratës se punës për të gjithë personelin, përcaktimin e detyrave funksionale të punonjësve,përcaktimin dhe ndjekjen e fushave me rrisht

b.Te vendosen kriteret dhe ndiqet procedure e njejte per punonjesit e kualifikuar (trajnier profesionit,inspektor sportit) nga drejtuesit e Sportklubit per trajniert profesionist.

c. Plotesimin e dosjeve te punonjesve , kryerjen e vlersimit te punes se punonjesve.

4.Gjetje.Ka mangesi ne planifikimin e buxhetit,si dhe ne miratimin e perpilimin e gjurmes auditit per zbatimin e buxhetit.

Rekomandime

a. Planifikimi i buxhetit te behet bazuar ne tregues ekonomiko-financiare ne perputhje me nevojat qe ka institucioni.

b. Te kerkohet me shkrim, prane Drejtorise Planifikimit buxhetit ne Bashki per te marre asistencen e nevojshme per perpilimin e zbatimin e gjurmës auditit per buxhetin.

5.Gjetje.Është vepruar në kundërshtim me pikat 37-41, te udhezimit nr. 30 date 27.12.2011 Per menaxhimin e asetëve ne sektorin publik”, Nuk është ushtruar kontroll i brendshem sipas kerkesave te pikes 23/1 neni 4 dhe neni 12 i ligjit nr. 10296 date 08.07.2010 “Për menaxhimin financiare dhe kontrollin”i ndryshuar.

6.Gjetje.Jane dhene ne perdorim ambjentet pa autorizim te Keshillit Bashkiak duke vepruar ne kundërshtim me germa c neni 9 i ligjit 139/2015 “Per veteqeverisjen Vendore”

Rekomandime

a.Per te gjitha veprimet e letrave me vlere (bileta) te bëhet dokumentimi me flete hyrje-dalje, kartela magazine, udher dorezimi,si dhe te ushtrohet kontrolli i brendshem te pakten nje here ne muaj, duke mbajtur dhe akt rakordimi.

b.Te behet kerkese prane Keshillit Bashkiak per marrjen e autorizimit te perdorimit nga te trete si dhe te kerkohet miratimi i tarifave sipas natyres se perdorimit.

7.Gjetje: Nuk është mbajtur regjistri i pagave duke vepruar ne kundërshtim me piken 2 te V.k.M nr. 594 date 22.12.1997 “Per regjistrin që mban punëdhënesi për punemarresin e tij”.

Rekomandim: Te bëhet plotesimi i librit pagave sipas formatit miratuar.

8.Gjetje: Nuk eshte bere planifikim dhe kryerje shpenzimesh per transport dhe akomodim te sportistëve.

Rekomandim: Për te gjithë sportitet qe dergohen per te kryer aktivitete sportive , sipas kalendarit aktivitetëve sportive te bëhet planifikimi dhe mbulimi i shpenzimeve per transport e akomodim, me procedure prokurimit publik.

9.Gjetje:Është vepruar me protokoll të brendshëm te institucionit,jo rregullisht dhe nuk eshte vepruar, me protokoll te vecante per urdherat,proces verbalet,dokumentat e tenderit dhe shkresat me te trete ,per prokurimet publike.mungon gjurma e auditit në

kundërshtim me pikën 19/neni 4 ligjit 10296 datë 8.07.2011 "Menaxhimit Financiar" dhe Urdhërit nr 57 datë 12.06.2014 të Ministrit të Financave "Për gjurmën e auditit për blerjet me vlera të vogla".

Rekomandim :Dokumentacioni i prokurimit publik të regjistrohët në protokollin e sekretarisë dhe në përfundim të procedurës komisioni i vlerësimit të dërgojë me shkresë përmbledhese pranë Përgjegjësit të financës për likuidim.

10.Gjetje.Në prokurim Komisioni vlersues i prokurimeve nuk përbehet nga specialistë sipas natyrës së blerjes,mungon juristi.

Rekomandimi :Komisioni I vlerësimit duhet të përbehet nga profesionit të institucionit shpenzues sipas natyrës së blerjes ,të ketë edhe juristë dhe të përcaktohen në fillim të vitit me urdhër të brendshëm.

11.Gjetje: Fatura tatimore nuk është e nënshkruar nga antaret e komisionit vlerësimit ku bie ndesh me pikën 7 neni 40 i VKM nr nr. 914 dt. 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Rekomandim: Të bëhet nënshkrimi i faturave tatimore nga komisioni i vlersimit,në të gjitha rastet e blerjeve të vogla.

12.Gjetje: Është vepruar në kundërshtim me nenin 8 Ligji 10296 Dt.08.07.2010 MFK i ndryshuar, me pikën 114,140-144 të udhëzimit nr .2 Dt.06.02.2012 për "Zbatimin Standart të Buxhetit".

Rekomandim:Ndërprerjen e mënyrës së financimit deri në plotësimin e kushteve sipas argumentimit të pikës së mesipërme.

13.Gjetje:Është vepruar në kundërshtim me VKM Nr. 1720 Dt.29.10.2008 "Për kriteret e përcaktimit të nivelit të lartë sportiv,mënyrën e shpërbliit të sportistëve që i arrijnë këto nivele, si dhe për përfitimin e trajtimit për përparimet sportive",i ndyshuar,përkatesisht pikat 1 dhe 2,nuk është hartuar paraprakisht lista e sportistëve përfitues, nuk është hartuar marrëveshje dypalëshe e përfitimit,sportistët janë trajtuar me kuota ushqimi të diferencuara të paargumentuara,si dhe sportistët janë trajtuar me shumë se një herë me kuota ushqimore për të njëjten periudhë.

Rekomandime

a. Për të gjithë sportistët e federuar që trajtohen me kuota ushqimore,të lidhet akt marrëveshje individuale ku të përcaktohen detyrimet e paleve.

b. Nënpunësi autorizues bazuar në planin e buxhetit të miratuar, në bashkëpunim me specialistët e sportit në fillim të çdo muaji të përcaktojë kuotat ushqimore për çdo sportist që do përfitojnë gjatë muajit.

c. Stervitjet e kryera nga ana e sportisteve te dokumentohen me shkrim sipas oreve te kryera ne fakt dhe te nenshkruhen nga personat e autorizuar sipas rregullores se brendeshme.

d. Ne fund te cdo muaji, bazuar ne prezencen e sportisteve, dhe kuotat paraprake te miratuara te hartohet list pagesa per kuotat ushqimore dhe te kryhet pagesat nepermjet sistemit bankar.

e. Te behet kontroll i plote i kuotes ushqimore sipas sporteve dhe sportisteve per periudhen 2012-2016 si dhe te llogariten kuotat ushqimore te perfituara me teper se 300 dite sipas sportisteve dhe me pas te behet ndalesa per perfitimin ne kundershtrim me dispozitat ligjore.

14.Gjetje: Eshte vepruar ne kundershtri me germen b pika 3 te VKM Nr.354 DT.29.08.1994 "Per shperblimin e veprimtarive sportive per sportistet, trajnietet e gjyqatret dhe shperblimet e tjera per veprimtarite sportive", nuk esht bere miratimi paraprak i listes se sportisteve profesionist sipas sporteve, nuk esht dokumentuar perzgjedhja e trajnieteve sipas sporteve, ka mangesi ne formulimin e kontrates me trajnietet.

Rekomandime

a. Bazuar ne startegjine e zhvillimit te sportit ne bashkepunim me Drejtorine e kultures rinise dhe sporteve, te hartohet lista e trajnieteve sipas sporteve .

b. Marredheniet e sherbimit te percaktohet sipas kerkesave te percaktuara ne pjesen 5 Kreu I Ligji Nr.7850 DT.29.07.1994 Kodi Civil i Republikes se Shqiperise, i Ndyshuar, si dhe gernes b pika 3 te VKM Nr.354 DT.29.08.1994 "Per shperblimin e veprimtarive sportive per sportistet, trajnietet e gjyqatret dhe shperblimet e tjera per veprimtarite sportive", i ndryshuar.

15.Gjetje. Ka mangesi ne hartimin dhe miratimin rregullore per menaxhimin e aseteteve, per planin e veprimit lidhur me mirembajtjen e aktiveve, per ndjekjen ne rruge ligjore per marrjen ne perdorim te aseteteve qe jane ne perdorim nga te tretet, per ngritjen e komisionit te posacem per nxjerrjen e aktiveve nga perdorimi, si dhe ne administrin e automjete ne pronesi te SportKlub "Vllaznia".

Rekomandime

a. Ti kerkohet me shkrim bashkise Shkoder te rregullores se aseteteve te miratuar nga Kryetarja e Bashkise ,si dhe te kerkohet asistence per menaxhimin e aseteteve.

b .Ti kerkohet me shkrim Bashkise Shkoder e konkretisht Drejtorise Juridike duke derguar fotokopje te dokumentacionit ligjor, per asetet ne perdorim nga te trete ,per te

bere te mundur percaktimin ligjor te ketyre asetete si dhe ndjekjen e procedurave ligjore per marrjen ne perdorimin e ketyre asetete.

c .Te shlyhen te gjitha detyrimet prane Drejtorine Rajonale te Transportit Rrugor Shkoder per vleren 14.500 lek per te dy motomjetet.

16.Gjetje.Eshte vepruar ne kundersizim nenin 8 dhe 19 te ligjit nr.9736 DT.21.04.2006 “Per Sportin” i ndryshuar, si dhe pikes 1 te VKM nr.1718 DT.24.12.2008 “Per proçedurat e transferimit te klubeve sportive ne Shoqeri aksionere dhe per kriteret e percaktimit te kapitalit themeltar”,si dhe neni 24 i ligjit nr.10296 date 08.07.2010 “ Per menaxhimin financiar e kontrollin”.

Rekomandime

a. SportKlub Vllaznia ne bashkepunim me Drejtorine e Kultures,Rinise dhe Sporteve te hartoje politika dhe strategjite per zhvillimin e sportit dhe me pas te behet miratimi nga Kryetarja e Bashkise.

b.Ne reference te nenit 19 ligjit nr.9736 DT.21.04.2006 “Per Sportin” i ndryshuar, si dhe pikes 1 te VKM nr.1718 DT.24.12.2008 “Per proçedurat e transferimit te klubeve sportive ne Shoqeri aksionere dhe per kriteret e percaktimit te kapitalit themeltar” ti kerkohet Bashkise Shkoder fillimin e procedurave per kalimin e sportKlubit ne Shoqeri Aksionere e konkretishte :

- Nxejrrja e urdherit te Kryetari te Bashkise per ngritjen e komisionit per transferim te Sportklubit ne shoqeri aksionare dhe kriteret e percaktimit te kapitalit themelore,konkretishte komisioni :
 - Te pergatise proceduren e transferimit te Sportklubit ne shoqeri aksionare
 - Te percaktoje kapitalin e shoqerise duke u mbeshtetur ne bilancin e vitit ushtrimor financiar paraardhes,emrin e klubit dhe logos se tij.
 - Ti ofroje dokumentacionin e nevojshem ekspertit kontabel(te emeruar),per verifikimin dhe vertetimin e bilancit te celjes se shoqerise aksionare.
 - Te pergatise statutin,aktin e themelimit,rregulloret e funksionimit te shoqerise aksionare.
- Pergatitja nga kryetari i komisionit te raportit perbledhes te procedures se ndjekur dhe dergimi te Kryetare se Bashkise.
- Miratimi i transferimit te SportKlubit ne shoqeri aksionare,i aktit te themelimit dhe i statutit te shoqerise aksionere nga Keshilli Bashkiake.
- Miratimi i vleresimit te emrit dhe logos se Sportklubit nga Keshilli Bashkiak.

Njesia Auditimit Brendshem

Bashkia SHKODER

